

Kids Athletics, 11.12.2019



Federata Shqiptare e Atletikës, në bashkëpunim me Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar, shkollën “Faik Konica” dhe Universitetin e Sporteve më datë 11 Dhjetor 2019, në Ditën Olimpikë të Solidaritetit ndaj dëmeve të tërmetit, organizuan aktivitetin “Kids Athletics”.

Ky aktivitet u zhvillua gjatë paradites në ambjentet e Universitetit të Sporteve.

Programi “Kids Athletics” u zhvillua në një formë loje për të argëtuar dhe njëkohësisht për të prezantuar një mësimdhënie për sportin tek fëmijët.

Për të parë aktivitetin e pasqyruar me video nga KOKSH klikoni [këtu](#).





